

Regjistrohu. Përzgjidh. Vepro!



**Aplikimi është i thjeshtë!  
Ndiq këto hapa**


Apliko në **e-Albania**, duke përzgjedhur shërbimin “Aplikim për Garancinë Rinore (Punësim, Arsimit dhe Formim Profesional)” ose duke përdorur kodin QR pënbri.

Oakto një takim me këshilluesin e punësimit në Zyrën e Punës më të afërt gjatë regjistrimit online, për të të ndihmuar që të zgjedhësh mbështetjen e duhur.



**APLIKO TANI**

**Bashkitë pjesë e fazës pilot**



Mëso më shumë  
[Garancia.Rinore.al](https://Garancia.Rinore.al)



# Garancia Rinore në Shqipëri

**Hapi i parë drejt punësimit  
dhe zhvillimit profesional**



**Nëse je në kërkim të një pune ose dëshiron të rritesh profesionalisht, Garancia Rinore është këtu për të të mbështetur.**

Ky program ofron një rrugëzgjdhje të qartë për të rinjtë që nuk janë aktualisht në punë, shkollë apo trajnim, duke u siguruar atyre mbështetje të personalizuar për t'u integruar në tregun e punës brenda 4 muajve.

Përmes këtij programi mundësitë janë të shumta:

#### Informim mbi tregun e punës

Mësoni për profesionet më të kërkuara, sektorët në zhvillim dhe aftësitë që kërkohen sot.



#### Çfarë përfiton?

- 1 Mbështetje e personalizuar
- 2 Shërbime falas dhe të aksesueshme
- 3 Mundësi reale për punësim dhe zhvillim profesional
- 4 Qasje në një rrjet kombëtar të zyrave të punës dhe partnerëve

#### Ndërmjetësim për punësim

Ne të ndihmojmë të gjesh mundësi konkrete punësimi dhe të prezantohesh te punëdhënësit e duhur.

#### Praktika profesionale (Internship)

Merr eksperiencë në biznes ose institucion publik dhe ndërto rrjetin tënd profesional që në hapat e parë.

#### Pjesëmarrje në programet e nxitjes së punësimit

Përfito nga programe me mbështetje financiare dhe stimuj që ndihmojnë ty dhe punëdhënësin tënd të ardhshëm të ecni përpara së bashku.

**Garancia Rinore të jep mundësinë të ndjekësh kurse profesionale falas dhe të ndërtoësh një profil konkurrues në tregun e punës.**

Mund të zgjedhësh prej më shumë se 100 kurse në 10 Qendra Publike të Formimit Profesional të shpërndara në të gjithë vendin.

Këshillim për karrierën dhe përzgjedhjen e profesionit  
Zbulo profesionet që i përshtaten aftësive dhe interesave të tua me ndihmën e këshilltarëve tanë.

#### Trajnime profesionale në qendrat publike të formimit profesional

Përfito nga kurse praktike të cilësisë së lartë në qendra publike të formimit profesional.



#### Çfarë përfiton?

- 1 Mëson një profesion të kërkuar
- 2 Kurse profesionale pa pagesë
- 3 Rritje të mundësive për punësim
- 4 Mbështetje nga këshilltarë profesionistë
- 5 Certifikim i njohur në tregun e punës

#### Formim profesional pa pagesë

Ti përqëndrohesh në të mësuarit, kursi ofrohet plotësisht falas për të rinjtë e Garancisë Rinore.

#### Kurset e Programimit & Kodimit

Zhvillo aftësi që kërkohen gjithnjë e më shumë në tregun e punës! Përfito subvencionim 100% të kostos.

#### Lidhje me tregun e punës pas trajnimit

Pas përfundimit të kursit, të ndihmojmë në një tranzicion të qëndrueshëm në profesionin e mësuar.

#### Praktikë profesionale/Trajnim

“Të nxënit në vendin e punës”, të mundëson aftësim në profesionin e dëshiruar përmes një programi që kombinon trajnim teorik me praktikë intensive në biznes.

**Arsimi profesional të pajis me njohuri dhe aftësi të zbatueshme, duke të përgatitur për tregun e punës që nga dita e parë. Ja çfarë e bën të veçantë...**

#### Proces mësimor dinamik dhe praktik

Në shkollat e arsimit profesional, mësimi zhvillohet në kushte reale pune, duke të përgatitur që nga dita e parë për sukses jashtë bankave të shkollës.

#### Rrjet i gjerë institucionesh publike

Në të gjithë vendin funksionojnë 31 shkolla profesionale publike, që ofrojnë kualifikime të mesme dhe pas të mesme për të rinjtë.

#### Mundësi të larmishme studimi

Zgjidh mes 26 drejtimeve të cilat diversifikohen në 83 profile – në fusha si teknologji, turizëm, ndërtim, ekonomi, shërbime, e shumë të tjera.

#### Arsim Dual

3 ditë në biznes dhe 2 ditë në shkollë në 6 profile duali (reception, kuzhinë, multimedia, shërbim elektroauto, instalime TU, TM dhe TL dhe menaxhimi i strukturave hoteliere).

#### Kualifikimet Profesionale Pas të Mesme (1–2 vjeçare)

Zgjidh një kualifikim 1–2 vjeçar pas të mesëm për një specializim cilësor dhe integrim të menjëhershëm në tregun e punës.



#### Çfarë përfiton?

- 1 Fiton aftësi të kërkuara nga tregu i punës
- 2 Mëson në kushte reale dhe me pajisje bashkëkohore
- 3 Hap rrugë për punësim të shpejtë ose vazhdim të mëtejshëm të studimeve
- 4 Bëhesh pjesë e një sistemi që të përgatit për të ardhmen, jo vetëm për provimet
- 5 Mund të përfitosh bursë të plotë ose të pjesshme

# Punësim

# Formim

# Arsim